



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

www.legjislacioni.gov.al

Nr. 86

Datë 11 qershor 2014

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Vendim i GJK nr. 31, datë 26.5.2014	Me objekt shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, të vendimit nr.00-2012-296 (49), datë 31.1.2012 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.....	3515
Vendim i GJK nr. 32, datë 26.5.2014	Me objekt konstatimin e cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, si pasojë e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë brenda një afati të arsyeshëm nga autoritetet e ngarkuara nga ligji.....	3519

VENDIM
Nr. 31, datë 26.5.2014

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar i Gjykatës Kushtetuese		
Vladimir Kristo	anëtar i	“	“
Sokol Berberi	anëtar i	“	“
Altina Xhoxhaj	anëtare e	“	“
Fatmir Hoxha	anëtar i	“	“
Gani Dizdari	anëtar i	“	“
Besnik Imeraj	anëtar i	“	“
Vitore Tusha	anëtare e	“	“

me sekretare Edmira Babaj, në datën 3.4.2014 mori në shqyrtim, në seancë plenare mbi bazë dokumentesh, çështjen nr. 10 Akti, që i përket:

KËRKUES: Shpëtim Hasanaliaj

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit; Drejtoria e Policisë së Qarkut Vlorë.

OBJEKTI: Shfuqizimi si i papajtuashëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, i vendimit nr. 00-2012-296 (49), datë 31.1.2012 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 16/2, 41/1, 42, 131/f, 132/1, dhe 134/g të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë; neni 6 i Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut; nenet 27 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 2.10.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, Vitore Tusha; mori në shqyrtim pretendimet e paraqitura me shkrim nga kërkuesi, që kërkoi pranimin e kërkesës, dhe prapësimet me shkrim të subjekteve të interesuara që kërkuan rrëzimin e kërkesës dhe pasi bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Kërkuesi ka punuar në pozicionin e specialistit të kërkimit në Seksionin e Policisë Kriminale në Komisarriatin e Policisë Vlorë deri në vitin 2006, kur i është komunikuar shkresa nr. 818, datë 8.12.2006 e policisë Vlorë, për largimin nga puna me motivacionin “shkurtim të funksionit organik”. Urdhri i shkarkimit ka dalë në zbatim të vendimit nr. 2585/3 të Drejtorisë së Policisë së Shtetit, neneve 19, pika 2; 20, pika 1, germa “c” të ligjit nr. 8553, datë 25.11.1995 “Për Policinë e Shtetit”, urdhrin nr. 689, datë 25.10.2006 “Për ristrukturimin dhe përbërjen organike të Drejtorisë së Policisë së Qarkut Vlorë”, propozimeve të Drejtorisë së Qarkut Vlorë dhe propozimeve të Këshillit Qendror Emërues.

2. Urdhri i shkarkimit nga puna është kundërshtuar nga kërkuesi në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me kërkesëpadi me objekt “Detyrimin e të paditurve për anulimin e urdhrin nr. 2583/3, datë 30.11.2006, si dhe përfitimin e të gjitha të drejtave që rrjedhin prej tij. Pagimi i pagës për gjithë periudhën e mbetur pa punë, me gradën inspektor, e cila i është hequr padrejtësisht një muaj përpara lirimimit nga detyra si dhe paga që përfitonte bashkëshortja nga transferata”.

3. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me vendimin nr. 1237, datë 11.6.2007, ka vendosur “Pranimin pjesërisht të padisë duke detyruar palët e paditura t’i paguajnë paditësit shpërblim dëmi për largim të padrejtë nga puna në masën e 8 muajve pagë. Rrëzimin e padisë për kërkimet e tjera.”

4. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 545, datë 9.10.2007, ka vendosur ndryshimin e vendimit të mësipërm në këtë mënyrë: “Pranimin e pjesëshëm të padisë duke i detyruar të paditurit të shpërblejnë paditësin me 12 paga mujore për largim pa të drejtë nga puna. Detyrimin e të paditurve t’i paguajnë paditësit 12 paga mujore që përfitonte bashkëshortja e tij si trajtim i veçantë familjar. Rrëzimin e padisë për pjesën tjetër.”

5. Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit ka paraqitur rekurs në Gjykatën e Lartë dhe ndërkohë që rekursi ende nuk ishte marrë në shqyrtim, kërkuesi me urdhrin nr. 324/1, datë 7.2.2011 është ripunësuar në strukturat e Policisë së Shtetit me detyrë “specialist” dhe gradën policore “nënkomisar”. Të drejtat administrative dhe financiare i kanë filluar nga data 9.2.2011.

6. Ndërkohë Gjykata e Lartë, pasi ka marrë në shqyrtim në seancë gjyqësore rekursin e paraqitur nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, me vendimin 00-2012-296, datë 31.1.2012 ka vendosur: “Ndryshimin e vendimit nr. 545, datë 9.10.2007 të Gjykatës së Apelit Vlorë dhe vendimit nr. 1237, datë 11.6.2007 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë dhe rrëzimin e padisë.”

II

7. **Kërkuesi** i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese në datën 25.11.2013 duke pretenduar cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor gjatë procesit gjyqësor të zhvilluar në Gjykatën e Lartë, në aspektet e mëposhtme:

7.1. Mosnjoftimi efektiv mbi procesin gjyqësor i ka cenuar kërkuesit të drejtën e mbrojtjes, në drejtim të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit. Padijenja mbi zhvillimin e procesit ka qenë rrjedhojë e mosnjoftimit të tij edhe pamundësisë objektive të mbrojtësit të zgjedhur, i cili në periudhën 16.10.2011 – 25.2.2012 ka qenë i shtruar në spital në Itali dhe pasi është kthyer në Shqipëri ka ndërruar jetë.

7.2. Është cenuar *parimi i sigurisë juridike*, pasi Gjykata e Lartë nuk ka marrë parasysh faktin që vendimi i Gjykatës së Apelit ishte një vendim i formës

së prerë dhe që ishte vënë në ekzekutim. Për më tepër, ndryshimi i vendimeve gjyqësore dhe rrëzimi i padisë është bazuar në vendimin unifikues nr. 31, datë 14.4.2003 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë i cili e kishte humbur fuqinë si rezultat i disa shtesave dhe ndryshimeve në Kodin e Punës. Po ashtu, arsyetimi i Gjykatës së Lartë bie ndesh me faktet që rezultojnë nga aktet shkresore të depozituara gjatë zgjidhjes në themel të çështjes. Shkarkimi nga detyra nuk është bërë për shkak të ristrukturimit të njësisë policore ku kërkuesi ushtronte funksionin.

8. Subjekti i interesuar, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, ka prapësuar se:

8.1 Pretendimi i kërkuesit për cenimin e parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit është i pabazuar, për faktin se procesi gjyqësor në Gjykatën e Lartë është zhvilluar në mungesë edhe të palës paditëse, e cila përveç rekursit nuk ka depozituar dokumente që do ta bënin të nevojshme shprehjen mbi to të palës së paditur.

8.2 Edhe pretendimi i kërkuesit mbi cenimin e parimit të sigurisë juridike si rezultat i padijenisë për procesin gjyqësor të zhvilluar në Gjykatën e Lartë është i pabazuar, për faktin se ai është njoftuar mbi rekursin dhe po ashtu kishte mundësi të ushtronte të drejtën e kundër rekursit, sipas parashikimeve të nenit 477 të KPC-së. Në lidhje me pretendimin e kërkuesit për referimin në vendimin unifikues nr. 31, datë 14.4.2003, të shfuqizuar, kërkuesi nuk legjitimohet të parashtojë një argument të tillë, pasi përfshihet në rrethin e çështjeve që i përkasin juridiksionit të zakonshëm dhe jo atij kushtetues.

II

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Lidhur me pretendimin për cenimin e të drejtës së mbrojtjes në Gjykatën e Lartë

9. Kërkuesi ka pretenduar shfuqizimin e vendimit të Gjykatës së Lartë, duke argumentuar se nuk janë respektuar procedurat e njoftimit për zhvillimin e procesit gjyqësor që ka marrë në shqyrtim rekursin e paraqitur nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit. Sipas kërkuesit, edhe mbrojtësi i zgjedhur prej tij ka qenë në pamundësi objektive për të qenë i pranishëm, pasi ka qenë jashtë Shqipërisë për mjekim dhe kur është kthyer ka ndërruar jetë. Për rrjedhojë, sipas kërkuesit është cenuar e drejta mbrojtjes, në drejtim të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit.

10. Gjykata, në jurisprudencën e saj, ka përcaktuar disa standarde kushtetuese, të cilat janë të lidhura nga pikëpamja organike dhe funksionale me njëra-tjetrën, në mënyrë të tillë që cenimi i njërit standard ndikon në mënyrë të pashmangshme në cenimin e të tjerave. Konkretisht, e drejta për t'u njoftuar për një gjykim dhe pjesëmarrja në të është e lidhur me vendimmarrjen e

gjykatës, e cila ndikon drejtpërsëdrejti mbi të drejtat subjektive ose interesat e ligjshme të individit. Nga ana tjetër, e drejta për të marrë pjesë në gjykim krijon të njëjtat mundësi, për të paraqitur prova dhe argumente në mbrojtje të interesave vetjake, në raport me palën kundërshtare. E drejta për t'u njoftuar për të marrë pjesë në gjykim, i paraprin të drejtave të tjera, pasi, nëse pala ndërgjyqëse nuk njoftohet për datën dhe orën e seancës, ajo detyrimisht do të gjendet në pamundësi objektive për të ushtruar të drejtat që i garantohen nga neni 42 i Kushtetutës, në kuadrin e një procesi të rregullt ligjor (shih vendimet nr. 34, datë 3.10.2007; nr.34, datë 25.7.2011; nr. 18, datë 23.4.2013, të Gjykatës Kushtetuese).

11. Parimi i barazisë së armëve nënkupton se çdokush që është palë në proces duhet të ketë mundësi të barabarta që të paraqesë çështjen e tij dhe se asnjë palë nuk duhet të gëzojë avantazh të konsiderueshëm ndaj palës tjetër, por duhet të përcaktohet një ekuilibër i drejtë mes palëve. E drejta për të marrë pjesë në gjykim nuk duhet konsideruar si një e drejtë formale, ku palëve t'u garantohet thjesht prania fizike gjatë procesit civil, por, përkundrazi, duhet që legjislacioni procedural, në radhë të parë, dhe më pas gjyqtari gjatë gjykimit, t'u japin mundësi të barabarta palëve, për të paraqitur argumente dhe prova në mbrojtje të interesave të tyre. Nëse nuk do të ekzistonte barazia e armëve në gjykimin civil, atëherë argumentet e njëres palë do të prevalonin mbi argumentet e palës së cenuar dhe, për rrjedhojë, e drejta për të marrë pjesë në gjykim do të zhvishej nga funksioni i saj kushtetues, për të garantuar një proces të rregullt ligjor. Bazuar në këto parime, gjykatës i dalin një sërë detyrash, mes të cilave rëndësi të veçantë merr krijimi i mundësive të barabarta për pjesëmarrjen e palëve apo përfaqësuesve të tyre në proces, si dhe mundësia e deklarimit të tyre për faktet, provat dhe vlerësimet ligjore që janë të lidhura ngushtë me çështjen që shqyrtohet në gjykatë (shih vendimin nr. 19, datë 12.6.2003; nr. 18, datë 23.4.2013 të Gjykatës Kushtetuese).

12. Gjykata konstaton se në dosjen gjyqësore gjendet e administruar një "Dëftesë komunikimi" e rekursit të depozituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, e datës 5.2.2008 dhe mban shënimin "... për Shpëtim Hasanaliaj, ka dijëni përfaqësuesi L.Xhuveli". Po ashtu, Gjykata vëren se për sa u përket fakteve të pretenduara nga kërkuesi që kanë çuar në pamundësinë objektive të marrjes dijëni nga mbrojtësi i tij, nga aktet bashkëngjitur parashtrimeve përfundimtare të kërkuesit në Gjykatën Kushtetuese, rezulton se mbrojtësi i tij ka ndërruar jetë në datën 26.2.2012, e provuar nga certifikata e vdekjes, lëshuar nga zyra e gjendjes civile Vlorë, datë 11.3.2014, ndërsa fakti që mbrojtësi ka qenë në Itali, provohet nga kopja e printuar nga sistemi TIMS

të hyrje-daljeve. Nga procesverbali i seancës gjyqësore të zhvilluar në Gjykatën e Lartë në datën 31.1.2012, rezulton se asnjë nga palët ndërgjyqëse të thirrura nuk ishte paraqitur ndërkohë që “*kishin dijeni rregullisht me njoftimin e shpalljes së datës 16.1.2012 dhe shkak për mosparaqitje nuk kishte*”.

13. Në vështrim të sa më sipër, Gjykata, bazuar në faktin se njoftimi për ditën dhe orën e gjykimit të çështjes është bërë nga Gjykata e Lartë me shpallje, duke i afishuar listat e çështjeve për gjykim, vlerëson se pretendimi i kërkuarit, për mosrespektimin e procedurave të njoftimit nga Gjykata e Lartë, është i pabazuar.

B. Lidhur me pretendimin për cenimin e parimit të sigurisë juridike

14. Sipas kërkuarit, Gjykata e Lartë, për zgjidhjen e çështjes, bazohet në vendimin unifikues nr. 31/2003 të KBGJL-së, i cili ka rënë nga fuqia për faktin se ligjvënësi ka miratuar disa ndryshime në nenin 146/3 të Kodin të Punës. Po ashtu, sipas kërkuarit, faktet dhe provat mbi të cilat është bazuar zgjidhja në themel e çështjes në gjykatat e dy shkallëve të para janë vlerësuar ndryshe nga Gjykata e Lartë.

15. Gjykata ka ritheksuar se interpretimi i ligjeve është kompetencë e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm dhe sidomos e Gjykatës së Lartë. Në këtë kuptim, Kushtetuta i ka dhënë Gjykatës së Lartë autoritetin të njësojë ose ndryshojë praktikën gjyqësore, pra të mbajë qëndrime në çështje të veçanta me qëllim unifikimin e vendimmarrjes së gjykatave të zakonshme (*shih vendimin nr. 6, datë 17.2.2012, të Gjykatës Kushtetuese*).

16. Në kuptim të funksionit rishikues të Gjykatës së Lartë, i sanksionuar në nenin 141 të Kushtetutës, Gjykata ka vlerësuar se kompetenca e saj për shqyrtimin e çështjeve nuk bazohet mbi të njëjtat dispozita procedurale të cilave u referohen gjykata e shkallës së parë dhe gjykata e apelit. Në të drejtën procedurale civile kufijtë brenda të cilëve Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë shqyrton çështjet mbi rekursin e ushtruar janë parashikuar në nenet 472 dhe 485 të KPC-së. Sipas nenit 472 të KPC-së, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka në kompetencë të shqyrtojë problemet që kanë të bëjnë me mosrespektimin ose zbatimin e gabuar të ligjit material e procedural, kurse neni 485 i KPC-së i ka dhënë të drejtë Kolegjit Civil apo Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë që, ndër të tjera, të vendosin prishjen e vendimit të gjykatës së apelit dhe të lënë në fuqi vendimin e gjykatës së shkallës së parë, si dhe të ndryshojnë njëkohësisht vendimet e të dy gjykatave më të ulëta (*shih vendimet nr. 31, datë 1.12.2005; nr. 7, datë 9.3.2009; nr. 27, datë 24.6.2013 të Gjykatës Kushtetuese*).

17. Në jurisprudencën kushtetuese është theksuar se procesi nuk konsiderohet i parregullt, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës, kur Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë,

mbi të njëjtat prova e fakte të vlerësuara në gjykimet e mëparshme, vendos të prishë vendimet dhe zgjidh vetë çështjen, për shkak të zbatimit të gabuar të ligjit (*shih vendimet nr. 7, datë 9.3.2009; nr. 27, datë 24.6.2013 të Gjykatës Kushtetuese*). Kontrolli i Gjykatës së Lartë duhet të fokusohet vetëm në drejtim të ligjshmërisë dhe bazueshmërisë së vendimeve të ankmuara, pra mbi mënyrën e zbatimit të ligjit nga gjykatat më të ulëta. Gjykata e Lartë nuk mund të anashkalojë apo të lërë pa vlerë prova që janë shqyrtuar dhe vlerësuar nga gjykatat e faktit, si dhe nuk mund të pranojë prova të cilat nuk janë administruar në gjykimin në fakt. Gjykata rithekson se kusht për dhënien nga Gjykata e Lartë të një vendimi mbi themelin e çështjes, në kuptim të nenit 485 të KPC-së, është që jo vetëm të mos nevojitet administrimi i provave të reja, por edhe që provat e administruara të jenë shqyrtuar dhe vlerësuar në mënyrë të mjaftueshme nga gjyqtari i faktit (*shih vendimin nr. 27, datë 24.6.2013 të Gjykatës Kushtetuese*).

18. Në rastin në shqyrtim, Gjykata vlerëson se, në ndryshim nga sa pretendon kërkuari, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka respektuar kufijtë e shqyrtimit të çështjes që i njihen atij, duke e përqendruar vlerësimin e tij në përcaktimin e marrëdhënies së veçantë të punës që përcakton ligji nr. 8553/1999 “Për Policinë e Shtetit”. Kjo gjykatë, duke u bazuar në provat e administruara në gjykimin e faktit, i ka analizuar dhe vlerësuar ato në vështrim të dispozitave ligjore të zbatueshme si dhe jurisprudencës së vetë asaj gjykate, duke arritur në përfundimin se gjykatat e shkallëve më të ulëta kanë bërë një interpretim të gabuar të ligjit dhe, për këto arsye, i ka ndryshuar vendimet duke rrëzuar padinë.

19. Bazuar në sa më sipër, Gjykata vlerëson se referimi në vendime unifikuese, si pjesë e arsytimit të vendimeve gjyqësore, hyn në vlerësimin diskrecional të gjyqtarit të zakonshëm gjatë gjykimit të çështjeve konkrete. Në këtë kuptim, në çështjen në shqyrtim, Gjykata vlerëson se argumentet e parashtruara nga kërkuari, në mbështetje të pretendimit për cenimin e parimit të sigurisë juridike, janë të pabazuara.

20. Në përfundim, Gjykata vlerëson se pretendimet e parashtruara nga kërkuari për cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut janë të pabazuara dhe, për rrjedhojë, kërkesa duhet rrëzuar.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 131, shkronja “f”, dhe nenit 134, pika 1, shkronja “g”, të Kushtetutës; neneve 72 dhe 77 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

VENDOSI:

Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë pro: Sokol Berberi, Vladimir Kristo, Gani Dizdari, Fatmir Hoxha, Besnik Imeraj.

Anëtarë kundër: Bashkim Dedja (kryetar), Altina Xhoxhaj, Vitore Tusha.

MENDIM PAKICE

Për arsye se nuk ndajmë të njëjtin qëndrim me shumicën lidhur me përfundimin e arritur në lidhje me procesin gjyqësor të zhvilluar në Gjykatën e Lartë dhe argumentet mbi të cilat mbështetet ky qëndrim, çmojmë të shprehemi me mendim pakice.

1. Kërkuesi, midis të tjerash, ka pretenduar cenimin e parimit të sigurisë juridike duke parashtruar dy argumente: *së pari*, faktin që Gjykata e Lartë, për zgjidhjen e çështjes, bazohet në vendimin unifikues nr. 31/2003 të KBGJL, i cili ka rënë nga fuqia për faktin se ligjvënësi ka miratuar disa ndryshime në nenin 146/3 të Kodin të Punës. *Së dyti*, kërkuesi argumenton se arsyetimi i Gjykatës së Lartë bie ndesh me faktet që rezultojnë nga aktet shkresore të administruara gjatë zgjidhjes në themel të çështjes, pasi shkarkimi i tij nga detyra nuk është bërë për shkak të ristrukturimit të njësisë policore ku ai ushtronte funksionin. Sipas tij, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka arritur në një konkluzion të ndryshëm që bie në kundërshtim me interpretimin e bërë nga gjykatat e dy shkallëve më të ulëta dhe duke anashkaluar argumentet juridike të përdorura prej tyre.

2. Shumica, duke e analizuar pretendimin e kërkuesit nën dritën e parimit të sigurisë juridike, arsyeton se: *“Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka respektuar kufijtë e shqyrtimit të çështjes që i njihen atij, duke e përqendruar vlerësimin e tij në përcaktimin e marrëdhënies së veçantë të punës që përcakton ligji nr. 8553/1999 “Për Policinë e Shtetit”. Kjo gjykatë, duke u bazuar në provat e administruara në gjykimin e faktit, i ka analizuar dhe vlerësuar ato në vështrim të dispozitave ligjore të zbatueshme, si dhe jurisprudencës së vetë asaj gjykate, duke arritur në përfundimin se gjykatat e shkallëve më të ulëta kanë bërë një interpretim të gabuar të ligjit dhe, për këto arsye, i ka ndryshuar vendimet duke rrëzuar padinë”*.

3. Nisur nga natyra e pretendimeve të kërkuesit dhe po ashtu, bazuar në parimin *jura novit curia*, mendojmë se shumica, duke qenë se nuk e konsideron veten të detyruar nga cilësimi që i është bërë fakteve të çështjes nga kërkuesi, kishte mundësinë të vlerësonte nëse pretendimet e ngritura në kërkesë bien në fushën e veprimit të një dispozite të caktuar, që nuk është

parashtruar para saj. Në këtë kuptim, vlerësojmë se pretendimet e mësipërme të kërkuesit duhet të ishin trajtuar nga shumica në këndvështrim të respektimit të parimit të gjykatës së caktuar me ligj, si element i së drejtës për një proces të rregullt ligjor, të sanksionuar në nenin 42 të Kushtetutës. Në thelb ky parim nënkupton të drejtën e çdo pale për t’u dëgjuar në seancë përpara një gjykate kompetente dhe të caktuar me ligj; e thënë ndryshe që gjykata të ketë juridiksion për të gjykuar çështjen dhe që kompetenca për të vendosur për të t’i jetë njohur nëpërmjet ligjit (*shih vendimet nr. 31, datë 1.12.2005; nr. 7, datë 9.3.2009; nr. 22, datë 22.7.2009; nr. 27, datë 24.6.2013 të Gjykatës Kushtetuese*).

4. Në kuptim të funksionit rishikues të Gjykatës së Lartë, i sanksionuar në nenin 141 të Kushtetutës, kompetenca e saj për shqyrtimin e çështjeve nuk bazohet mbi të njëjtat dispozita procedurale të cilave u referohen gjykata e shkallës së parë dhe gjykata e apelit. Në të drejtën procedurale civile kufijtë brenda të cilëve Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë shqyrton çështjet mbi rekursin e ushtruar janë parashikuar në nenet 472 dhe 485 të KPC-së. Sipas nenit 472 të KPC-së, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka në kompetencë të shqyrtojë problemet që kanë të bëjnë me mosrespektimin ose zbatimin e gabuar të ligjit material e procedural, kurse neni 485 i KPC-së i ka dhënë të drejtë Kolegjit Civil apo Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë që, ndër të tjera, të vendosin prishjen e vendimit të gjykatës së apelit dhe të lënë në fuqi vendimin e gjykatës së shkallës së parë, si dhe të ndryshojnë njëkohësisht vendimet e të dy gjykatave më të ulëta (*shih vendimet nr. 31, datë 1.12.2005; nr. 7, datë 9.3.2009; nr. 27, datë 24.6.2013, të Gjykatës Kushtetuese*).

5. Në jurisprudencën kushtetuese është theksuar se procesi nuk konsiderohet i parregullt, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës, kur Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, mbi të njëjtat prova e fakte të vlerësuar në gjykimet e mëparshme, vendos të prishë vendimet dhe zgjidh vetë çështjen, për shkak të zbatimit të gabuar të ligjit (*shih vendimet nr. 7, datë 9.3.2009; nr. 27, datë 24.6.2013 të Gjykatës Kushtetuese*). Në ushtrimin e funksionit të saj si gjykatë e ligjit, Gjykata e Lartë mund të vendosë për themelin e çështjes vetëm nëse mosmarrëveshja mund të zgjidhet në bazë të të njëjtave fakte dhe prova të vlerësuar nga gjyqtari i faktit dhe që përbëjnë bazën e vendimit në të cilin është bërë një interpretim i gabuar i ligjit. Kontrolli i saj duhet të fokusohet vetëm në drejtim të ligjshmërisë dhe bazueshmërisë së vendimeve të ankmuara, pra mbi mënyrën e zbatimit të ligjit nga gjykatat më të ulëta. Gjykata e Lartë nuk mund të anashkalojë apo të lërë pa vlerë prova që janë shqyrtuar dhe vlerësuar nga gjykatat e faktit si dhe nuk mund të pranojë prova të cilat nuk janë administruar në gjykimin

në fakt. Gjykata thekson se kusht për dhënien nga Gjykata e Lartë të një vendimi mbi themelin e çështjes, në kuptim të nenit 485 të KPC-së, është që jo vetëm të mos nevojitet administrimi i provave të reja, por edhe që provat e administruara të jenë shqyrtuar dhe vlerësuar në mënyrë të mjaftueshme nga gjyqtari i faktit (*shih vendimin nr. 27, datë 24.6.2013 të Gjykatës Kushtetuese*).

6. Duke i rikthyer çështjes konkrete, konstatohet se kërkuesi është ripranuar në strukturat e Policisë së Shtetit me detyrën “specialist” dhe gradën policore “nënkomisar” me urdhrin nr. 324/1, datë 7.2.2011 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, sipas të cilit të drejtat administrative dhe financiare të kërkuesit kanë rifilluar nga data 9.2.2011. Pas ripranimit në Policinë e Shtetit, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, në mungesë të palëve, ka marrë në shqyrtim rekursin e paraqitur nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit dhe ka vendosur ndryshimin e vendimeve gjyqësore dhe rrëzimin e padisë, me arsyetimin se: “midis palëve ndërgjyqëse ka ekzistuar një marrëdhënie e posaçme, e cila gjen rregullim në dispozitat e ligjit nr. 8553/1999 “Për Policinë e Shtetit”. Duke arsyetuar mbi një marrëdhënie juridike (pune) të njëjtë, KBGJL me vendimin nr. 31, datë 14.4.2003 kanë arsyetuar si vijon: “Ndërmjet palëve ndërgjyqëse ka ekzistuar një “kontratë e shërbimit publik”. KBGJL konkludojnë dhe udhëzojnë se kur “kontrata e shërbimit publik” zgjidhet dhe zgjidhja e saj është në përputhje me ligjin, nuk shtrohet për diskutim asnjë problem”. Kolegji Civil vijon arsyetimin se: “ndërprerja e marrëdhënies së veçantë të punës nuk është zgjidhur për shkak të shkeljes së ndonjë dispozite ligjore nga pala paditëse, por për shkak të ristrukturimit të njësisë policore, pranë së cilës shërbente pala paditëse. Në bazë të nenit 20, pika 1, shkronja “c” të ligjit nr. 8553/1999 “Për Policinë e Shtetit”, shkurtimi i funksionit organik është një nga rastet kur punonjësi i Policisë së Shtetit largohet nga detyra dhe në referencë të qëndrimit të mbajtur nga KBGJL në vendimin e sipërcituar, zgjidhja e kontratës që ekzistonte midis palëve duhej të ishte konsideruar e ligjshme nga gjykatat e faktit. Në këto kushte asnjë dëmshpërblim i njohur për palën paditëse nuk do të duhej të ishte zbatuar nga ana e gjykatave, pasi pala e paditur ka zbatuar drejt dispozitat ligjore.”

7. Nëse i referohemi vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, rezulton se ajo ka arritur në përfundimin se funksioni organik që ushtronte kërkuesi nuk është shkurtuar dhe bazuar në këtë fakt, ajo gjykatë e ka konsideruar largimin e paditësit nga puna pa shkaqe të arsyeshme, duke përcaktuar dëmshpërblimin përkatës. Po ashtu, edhe Gjykata e Apelit Vlorë, në arsyetimin e saj në të njëjtën linjë me atë të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, ka rikonfirmuar mosndryshimin

e strukturës organike dhe, për rrjedhojë, e ka vlerësuar largimin nga puna të padrejtë, duke i caktuar kërkuesit dëmshpërblim 12 muaj.

8. Kolegji Civil, në ndryshim nga qëndrimet e mësipërme, ka vlerësuar se struktura organike ka ndryshuar dhe, për rrjedhojë, ka arritur në përfundimin se kontrata është zgjidhur për shkaqe të arsyeshme dhe, për rrjedhojë, e ka rrëzuar kërkesën. Në këtë kuptim, Gjykata e Lartë ka vendosur për themelin e çështjes duke ndryshuar kuptimin e të njëjtave fakte dhe prova të vlerësuar nga gjykatat e shkallëve më të ulëta dhe po ashtu në tejkallim të kompetencës kontrolluese të ligjshmërisë dhe bazueshmërisë së vendimeve të ankmuara, pra mbi mënyrën e zbatimit të ligjit nga gjykatat më të ulëta.

9. Në këto kushte, vlerësojmë se zgjidhja e çështjes nga Gjykata e Lartë bie ndesh me parimin e gjykatës së caktuar me ligj dhe i ka cenuar kërkuesit të drejtën për një proces të rregullt ligjor në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar), Vitore Tusha.

VENDIM
Nr. 32, datë 26.5.2014

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar i Gjykatës Kushtetuese		
Vladimir Kristo	anëtar i	“	“
Sokol Berberi	anëtar i	“	“
Vitore Tusha	anëtare e	“	“
Altina Xhoxhaj	anëtare e	“	“
Gani Dizdari	anëtar i	“	“
Besnik Imeraj	anëtar i	“	“
Fatos Lulo	anëtar i	“	“
Fatmir Hoxha	anëtar i	“	“

me sekretare Blerina Basha (Çinari), në datën 5.12.2013, mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë dokumentesh çështjen nr. 49/21 Akti, që i përket:

KËRKUES: Kudret Kopo

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Këshilli i Lartë i Drejtësisë; zyra e përmbarimit “Bailiff Service Albania”.

OBJEKTI: Konstatimi i cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, si pasojë e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë brenda një afati të arsyeshëm nga autoritetet e ngarkuara nga ligji.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 131 shkronja “f”, 134 pika 1, shkronja “g” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; nenet 27 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoji relatorin e çështjes, Fatmir Hoxha, shqyrtoi pretendimet e kërkuessit, i cili kërkoi pranimin e kërkesës, pretendimet e subjektit të interesuar Këshilli i Lartë i Drejtësisë, i cili kërkoi rrëzimin e kërkesës dhe pasi bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Kërkuessi Kudret Kopo me vendimin nr. 24/2, datë 30.1.1999 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë (në vijim KLD) është emëruar në detyrën e inspektorit pranë KLD-së. Me ligjin nr. 8811/2001 "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë", është përcaktuar mandati 5-vjeçar i inspektorëve, me të drejtë rizgjedhjeje. Kërkuessi detyrën e inspektorit e ka vazhduar deri në datën 8.9.2008. Në këtë datë, KLD-ja ka konstatuar mbarimin e mandatit duke i ndërprerë marrëdhëniet e punës. Vendimin kërkuessi e ka ankimuar në rrugë gjyqësore.

2. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 3194, datë 21.4.2009, ka vendosur rrëzimin e kërkesë padisë.

3. Mbi ankimin e kërkuessit Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 1280, datë 29.6.2010, ka ndryshuar vendimin nr. 3194, datë 21.4.2009 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe duke gjykuar çështjen në fakt ka vendosur:

3.1 Pranimin e padisë;

3.2 Anulimin e pikës 8 të vendimit të KLD-së, nr. 234, datë 8.9.2008, në pjesën që bën fjalë për kërkuessin;

3.3 Anulimin e pikës 5 të vendimit nr. 227, datë 28.3.2008, të KLD-së, në pjesën që bën fjalë përkërkuessin; Detyrimin e subjektit të interesuar KLD-së, të pranojë kërkuessin që të vazhdojë detyrën e inspektorit deri në mbarimin e afatit të dytë 5-vjeçar;

3.4 Detyrimin e subjektit të interesuar, t'i paguajë kërkuessit pagën si inspektor, që nga momenti i ndërprerjes së marrëdhënies së punës në datën 8.9.2008 deri në ditën e ekzekutimit të këtij vendimi.

4. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi), me vendimin nr. 00-2011-997, datë 23.6.2011, ka vendosur mospranimin e rekursit, pasi nuk përmbante shkaqet e parashikuara nga neni 472 i Kodit të Procedurës Civile.

5. Në datën 14.7.2010, kërkuessi i është drejtuar Presidentit të Republikës, me cilësinë e kryetarit të KLD-së, duke kërkuar kthimin në punë sipas vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë.

6. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë me vendimin nr. 2775 akti, datë 5.10.2010 ka vendosur lëshimin e urdhrat të ekzekutimit. Kërkuessi në datën 22.11.2011 i është drejtuar subjektit të interesuar, zyrës së

përmbartimit "Bailiff Service Albania", për ekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë. Në datën 23.11.2011, zyra e përmbartimit ka bërë lajmërimin për ekzekutimin vullnetar të vendimit. Në datën 6.12.2011, zyra e përmbartimit ka vendosur masën e sekuestros konservative në llogarinë e thesarit për efekt të detyrimit ndaj kërkuessit.

7. Dega e Thesarit, në datën 21.12.2011, ka informuar KLD-në në lidhje me vendimin e sekuestros dhe ka kërkuar që të vepohet sipas afatit të udhëzimit të Këshillit të Ministrave për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore, pasi ndryshe do të ekzekutohej sekuestroja konservative dhe në datën 11.1.2012 me urdher të brendshëm ka bllokuar fondet në llogarinë 602 të subjektit të interesuar KLD-së për ekzekutimin e vendimit. Në datën 30.5.2012, Dega e Thesarit ka hequr sekuestron konservative pasi me shkresën nr. 100, datë 24.1.2012, është njoftuar nga KLD-ja se do të fillonte likuidimi pjesor i detyrimit.

8. Në datën 27.1.2012 kërkuessit i është paguar kësti i parë i detyrimit, si pagë neto për 17 muaj, në shumën 1.615.215.00 lekë. Në datën 7.12.2012, është paguar kësti i dytë, në shumën 1.978.683.00 si pagë neto për 21 muaj. Kësti i tretë dhe i fundit si pagë neto për 6 muajt e mbetur në shumën 574.674.00 lekë është paguar në datën 12.6.2013.

9. Kërkuessi, në datën 3.9.2012, i është drejtuar përsëri Presidentit të Republikës me cilësinë e Kryetarit të KLD-së, si dhe zv/Kryetarit të këtij këshilli, duke kërkuar zbatimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë për rikthimin në punë prej KLD-së.

10. Subjekti i interesuar KLD, me shkresën nr. 1849/2.prot, datë 6.11.2012, i ka komunikuar kërkuessit se: "...Gjykata e Apelit Tiranë, ka vendosur detyrimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë të pranojë paditësin Kudret Kopo, që të vazhdojë detyrën e inspektorit, deri në mbarimin e afatit të dytë 5-vjeçar, pra në datën 7.5.2012. Pranë KLD-së nuk është paraqitur nga ana juaj kërkesë për riemërim, para mbarimit të këtij afati. Kërkesa juaj për riemërim është paraqitur në datën 17.9.2012. Në këto kushte, KLD-ja nuk ka detyrimin ligjor për t'ju riemëruar në detyrën e inspektorit pranë inspektoratit të KLD-së."

II

11. **Kërkuessi** i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese duke pretenduar cenim të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, si pasojë e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë nr. 1280, datë 29.6.2010 të Gjykatës së Apelit Tiranë. Kërkuessi pretendon se si shkak i cenimit të së drejtës është sjellja e subjektit të interesuar KLD-së, lidhur me mosekzekutimin e detyrimit për rikthimin në punë si inspektor ose si gjyqtar apeli pa iu nënshtruar procedurave të konkurrimit, megjithëse kanë kaluar më shumë se dy

vjet nga dhënia e vendimit. Gjithashtu, ai ka kërkuar pagimin e diferencave të pagave të papaguara.

12. **Subjekti i interesuar**, Këshilli i Lartë i Drejtësisë ka paraqitur prapësime duke argumentuar:

12.1 Kërkuesi nuk legjitimohet, pasi subjekti i interesuar e ka ekzekutuar detyrimin financiar që kishte ndaj kërkuesit. Lidhur me kërkesën për ta rikthyer në punë, kërkuesi nuk ka interes të ligjshëm, pasi mandati i dytë i ka përfunduar në datën 7.5.2012.

12.2 Çështja e rikthimit në detyrë si inspektor apo emërimi i tij pa konkurs si gjyqtar në një gjykatë apeli është ligjërisht e pamundur. Mandati i dytë 5-vjeçar i kërkuesit si inspektor i KLD-së, ka mbaruar në datën 7.5.2012 dhe deri në këtë datë nuk ka pasur vende vakante për inspektor. Kërkuesi nuk mund të emërohet si gjyqtar në një gjykatë apeli, pasi ai nuk ka ushtruar ndonjëherë më parë detyrën e gjyqtarit.

III

A. Për legjitimitimin e kërkuesit

13. Subjekti i interesuar ka pretenduar se kërkuesi nuk legjitimohet në kërkesën për konstatimin e cenimit të parimit për një proces të rregullt ligjor, si pasojë e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë brenda afatit të arsyeshëm, pasi është përmbushur i gjithë detyrimi financiar i caktuar në vendimin gjyqësor, si dhe mandati i tij i dytë si inspektor ka mbaruar në datën 7.5.2012.

14. Gjykata Kushtetuese vlerëson se kërkuesi *prima facie* ka interes të ligjshëm për të kërkuar zbatimin e një vendimi gjyqësor brenda një afati të arsyeshëm. Në nenet 131 shkronja "f", 134 pika 1 shkronja "g" të Kushtetutës përcaktohet e drejta e individit për të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese për shkeljen e së drejtës për një proces të rregullt ligjor pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e këtyre të drejtave.

15. Gjykata Kushtetuese konstaton se në rastin konkret kërkuesi i është drejtuar gjykatave të juridiksionit të zakonshëm duke shteruar mjetet juridike për mbrojtjen e të drejtës së tij. Për ekzekutimin e vendimit gjyqësor, kërkuesi i është drejtuar subjektit të interesuar, i cili është organi kompetent për të përmbushur detyrimin e përcaktuar në vendimin gjyqësor të formës së prerë.

16. Për sa më sipër, Gjykata Kushtetuese arrin në përfundimin se kërkuesi legjitimohet për t'iu drejtuar kësaj Gjykate pasi nuk ka mjet tjetër ligjor për konstatimin e cenimit të parimit të procesit të rregullt ligjor si pasojë e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

B. Për pretendimin për mosekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë brenda një afati të arsyeshëm

17. Kërkuesi ka pretenduar se i është cenuar e drejta

për një proces të rregullt ligjor, si pasojë e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë nr. 1280, datë 29.6.2010 të Gjykatës së Apelit Tiranë. Nga dita e marrjes së vendimit formë të prerë dhe lëshimit të urdhrat të ekzekutimit ka kaluar një kohë e gjatë, e pajustificuar për ekzekutimin e tij.

18. Gjykata Kushtetuese, në jurisprudencën e saj tashmë të konsoliduar, ka theksuar se ekzekutimi brenda një afati të arsyeshëm i një vendimi gjyqësor të formës së prerë duhet konsideruar si pjesë përbërëse e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 6/1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Ekzekutimi i vendimit përbën një element thelbësor të shtetit të së drejtës e të vetë nocionit të gjykimit të drejtë. Asnjë organ shtetëror nuk mund të vërë në diskutim drejtësinë e vendimeve gjyqësore të formës së prerë. Çdo organ shtetëror detyrohet të marrë masat përkatëse për zbatimin e tyre (*shih vendimet nr.17, datë 23.4.2013, nr. 12, datë 15.4.2011; nr. 35, datë 27.10.2010; nr. 23, datë 17.5.2010; nr. 1, datë 19.1.2009 të Gjykatës Kushtetuese*).

19. Gjykata ka theksuar se ekzekutimi i vendimit gjyqësor të formës së prerë konsiderohet si faza përfundimtare e realizimit të një të drejte të fituar gjyqësisht. Vetëm pas realizimit të kësaj faze mund të konsiderohet se individit e ka vendosur plotësisht në vend të drejtën e tij të fituar. Procesi i vendosjes në vend të një të drejte të shkelur përfshin jo vetëm vendimmarrjen e gjykatave, por edhe veprimet konkrete të organeve përgjegjëse të ngarkuara me ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë. Pa dyshim që një vonesë në ekzekutimin e një vendimi mund të justifikohet në rrethana të veçanta, por vonesa nuk mund të jetë deri në atë shkallë sa të dëmtojë thelbin e të drejtës (*shih vendimet nr. 17, datë 23.4.2013, nr. 12, datë 15.4.2011; nr. 35, datë 27.10.2010; nr. 23, datë 17.5.2010; nr. 1, datë 19.1.2009 të Gjykatës Kushtetuese*).

20. Gjykata ka rikonfirmuar në disa vendime të saj qëndrimin se në një çështje që përfshin përcaktimin e një të drejte civile, kohëzgjatja e procedurave normalisht llogaritet nga momenti i fillimit të procedurës gjyqësore, deri në momentin kur jepet vendimi dhe ekzekutohet ai. Faza ekzekutive konsiderohet si fazë e mëtejshme e të njëjtit proces (*shih vendimet nr. 17, datë 23.4.2013, nr. 12, datë 15.4.2011; nr. 14, datë 15.4.2010; nr. 8, datë 23.3.2010; nr. 9, datë 1.4.2009; nr. 1, datë 19.1.2009 të Gjykatës Kushtetuese*).

21. Po ashtu, Gjykata, duke u bazuar edhe në jurisprudencën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, në mënyrë të vazhdueshme, ka rikonfirmuar se kohëzgjatja e arsyeshme e procedimeve duhet të

vlërësohet nën dritën e rrethanave të çështjes dhe duke marrë në konsideratë kompleksitetin e çështjes, sjelljen e kërkuarit dhe autoriteteve përkatëse. Për vlerësimin e kompleksitetit të procedimeve duhet të kenë rëndësi të gjitha aspektet e çështjes, përfshi objektin e çështjes, faktet e kundërshtuara, volumin e provave shkresore. Kompleksiteti i çështjes, në balancë me parimin e sigurimit të administrimit të përshtatshëm të drejtësisë, mund të justifikojë kohëzgjatje kohore të konsiderueshme (*shih vendimet nr. 17, datë 23.4.2013, nr. 12, datë 15.4.2011; nr. 35, datë 27.10.2010; nr. 23, datë 17.5.2010; nr. 1, datë 19.1.2009 të Gjykatës Kushtetuese*).

22. Organet shtetërore duhet të përmbushin detyrimet që rrjedhin nga një vendim gjyqësor sapo vendimi të bëhet i ekzekutueshëm. Vendimi i Gjykatës së Apelit, në përputhje me parashikimet e neneve 449 dhe 451 të KPC-së, është i formës së prerë dhe ushtrimi i rekursit ndaj tij pranë Gjykatës së Lartë nuk ka efekt pezullues, me përjashtim të rasteve kur kjo e fundit vendos pezullimin e vendimit në bazë të nenit 479 të KPC-së (*shih vendimin nr. 56, datë 21.12.2012 të Gjykatës Kushtetuese*).

23. Gjykata çmon se çështja në shqyrtim duhet të vlerësohet lidhur me natyrën e detyrimit që duhej të ishte përmbushur nga subjekti i interesuar. Konkretisht, pagimi i pagës si inspektor gjatë kohës që kërkuari nuk ka punuar si i tillë, për shkak të largimit nga detyra, si dhe rikthimi në detyrën e inspektorit deri në mbarimin e afatit të dytë 5-vjeçar.

24. Në rastin konkret, nuk rezulton që ekzekutimi i vendimit gjyqësor të jetë pezulluar me vendim të Gjykatës së Lartë, apo në fazën e veprimeve përmbarimore. Si i tillë, mund e duhet të ekzekutohej nga pala debitore, pa u kushtëzuar me veprimin e kërkuarit për ekzekutimin nëpërmjet procedurave përmbarimore.

i) Kompleksiteti i çështjes

25. Në lidhje me kompleksitetin e çështjes, Gjykata vëren që çështja konkrete nuk paraqet kompleksitet nga pikëpamja faktike ose ligjore. Kërkesa në shqyrtim ka për objekt mosekzekutimin e vendimit të formës së prerë brenda një afati të arsyeshëm, për sa i përket kthimit në punë dhe pagimit të kërkuarit për një periudhë të qëndrimit pa punë, duke filluar nga data 8.9.2008 e deri në ekzekutimin e vendimit gjyqësor.

ii) Sjellja e kërkuarit

26. Kohëzgjatja e arsyeshme e procedimit të çështjes është vlerësuar nga Gjykata si thelbësore për të përcaktuar nëse ndodhemi para rastit të tejkalimit të afateve të arsyeshme. Ky element lidhet me mosekzekutimin e vendimeve të formës së prerë për faj të veprimeve apo mosveprimeve të kërkuarit, duke sjellë tejkalimin e një afati të arsyeshëm për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë.

27. Në çështjen konkrete, sjellja e kërkuarit përcaktohet nga qëndrimi i tij gjatë fazës së ekzekutimit

të vendimit. Rezulton që kërkuari jo vetëm nuk është bërë pengesë për realizimin e procesit të ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, por ai ka shfaqur interes të vazhdueshëm për ekzekutimin e tij të plotë. Mëbshtetur në aktet e paraqitura rezulton se kërkuari, që në datën 27.9.2010, ka kërkuar lëshimin e urdhrit të ekzekutimit të vendimit nr. 3149, datë 21.4.2009, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, i ndryshuar nga vendimi nr. 1280, datë 29.6.2010, i Gjykatës së Apelit Tiranë, duke i kërkuar subjektit të interesuar ekzekutimin e këtij vendimi. Gjithashtu, kërkuari për ekzekutimin e vendimit i është drejtuar në mënyrë të përsëritur dhe Presidentit të Republikës. Në këtë mënyrë, sjellja e kërkuarit nuk ka shkaktuar vonesa.

iii) Sjellja e autoriteteve

28. Për sa i përket sjelljes së autoriteteve, Gjykata Kushtetuese ka theksuar se përballë detyrimit për zbatimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, të gjitha subjektet, qofshin këto private apo publike, duhet të përgjigjen njëjloj (*shih vendimin nr. 7, datë 27.2.2012 të Gjykatës Kushtetuese*). Në rastin në shqyrtim, përmbaruesi gjyqësor privat, si subjekt procedural në fushën e ekzekutimit, ka qenë i pajisur me të gjitha mjetet procedurale që mundësojnë ekzekutimin e titullit ekzekutiv. Nga dokumentet bashkëngjitur dosjes rezulton se nga përmbaruesi gjyqësor janë kryer të gjitha veprimet e nevojshme, por që kanë rezultuar të pasuksesshme për shkak të mosveprimit të debitorit, KLD-së.

29. Subjekti i interesuar është shprehur se është në pamundësi për të ekzekutuar detyrimin për të rikthyer kërkuarin në punë (referuar shkresës me nr. 1849/2 prot., datë 6.11.2012, të zv/Kryetarit të KLD-së) me argumentimin se "... pranë KLD-së nuk është paraqitur nga ana e kërkuarit ndonjë kërkesë për riemërim, para mbarimit të datës 7.5.2012. Kërkesa e kërkuarit për riemërim është paraqitur në datën 17.9.2012. Në këto kushte, KLD-ja nuk ka detyrimin ligjor për t'ju riemëruar në detyrën e inspektorit pranë inspektoratit të KLD-së.". Në këto kushte, subjekti i interesuar vijon t'i përmbahet qëndrimit, sipas të cilit ai është në pamundësi për të rikthyer kërkuarin në punë për shkak se nuk ka pasur kërkesë për rikthim në punë.

30. Gjykata, në jurisprudencën e saj, është shprehur se i takon debitorit të gjejë një mundësi zgjidhjeje sa më të përshtatshme për këtë rast, me qëllim vënien në vend të së drejtës së kreditorit (*shih vendimin nr. 2, datë 1.2.2011 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykata ka theksuar se shteti duhet të marrë përsipër vazhdimisht detyrimin për të siguruar palët pjesëmarrëse në proces se do të kenë mundësi reale të ekzekutojnë vendimin gjyqësor të formës së prerë dhe se e drejta për të pasur akses në gjykatë do të ishte iluzion, nëse sistemi ligjor ose zbatimi i tij në praktikë do të bëhej shkak që një vendim

gjyqësor i formës së prerë të mbetj inefektiv dhe i pazbatueshëm për një kohë tepër të gjatë (*shih vendimet nr. 13, datë 21.3.2012; nr. 43, datë 19.12.2007, të Gjykatës Kushtetuese*). Një vonesë në ekzekutimin e një vendimi mund të justifikohet në rrethana të veçanta, por vonesa nuk mund të jetë në atë shkallë sa të dëmtojë thelbin e së drejtës (*shih vendimet nr. 13, datë 21.3.2012; nr. 8, datë 23.3.2010; nr. 6, datë 6.3.2009; nr. 43, datë 19.12.2007 të Gjykatës Kushtetuese*).

31. Gjykata vëren se pretendimi i subjektit të interesuar se nuk kishte më vende vakante është i pabazuar, pasi sipas shpalljeve publike që vetë ky institucion ka bërë, rezulton se ka pasur disa vende vakante. Konkretisht, sipas vendimit nr. 268, datë 15.9.2010 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, rezulton se në mbledhje janë shqyrtuar kandidaturat për plotësimin e vendeve vakante për inspektorë pranë Inspektoratit të KLD-së, dhe pasi janë shqyrtuar propozimet e Zëvendëskryetarit është vendosur të emërohen dy inspektorë të tjerë, pa përfshirë kërkuesin. Sipas vendimit nr. 270, datë 12.11.2010 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, është vazhduar me shqyrtimin e kandidatave për plotësimin e vendeve vakante për inspektorë dhe pas këtij shqyrtimi është vendosur të emërohet si inspektor një person tjetër i ndryshëm nga kërkuesi. Sipas vendimit nr. 282, datë 16.12.2011 të KLD-së, është riemëruar në funksionin e inspektorit pranë Inspektoratit të KLD-së një inspektor, mandati i të cilit sapo kishte përfunduar.

32. Gjykata vëren se nuk qëndron pretendimi i subjektit të interesuar KLD, se kërkuesi nuk ka paraqitur kërkesë për rikthimin në punë. Detyrimi për kthimin në punë rrjedh nga një vendim gjyqësor. Gjithashtu kërkuesi ka paraqitur disa herë kërkesë pranë KLD-së duke kërkuar përmbushjen e këtij detyrimi.

33. Nga sa më sipër, Gjykata vëren se subjekti i interesuar, KLD-ja, ka pasur mundësinë për të ekzekutuar detyrimin ndaj kërkuesit, duke e rikthyer atë në detyrë, në zbatim të vendimit gjyqësor të formës së prerë.

34. Gjykata çmon se në lidhje me pagimin e pagës, si pjesë e detyrimit të përcaktuar me vendimin gjyqësor të formës së prerë, nuk konstatohet cenim i të drejtës për një proces të rregullt ligjor, pasi subjekti i interesuar ka shprehur vullnet dhe ka shlyer detyrimet për këtë pjesë, megjithëse detyrimi kryesor ishte kthimi i kërkuesit në punë.

35. Në përfundim, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuesit për cenim të së drejtës për një proces të rregullt ligjor si rrjedhojë e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë nga autoritetet e ngarkuara nga ligji dhe brenda një afati të arsyeshëm është i bazuar dhe duhet pranuar.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 131, shkronja “f” dhe nenit 134, pika 1, shkronja “g” të Kushtetutës, si dhe të neneve 72 dhe vijues të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

VENDOSI:

- Pranimin pjesërisht të kërkesës¹.

- Konstatimin e cenimit të së drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, si rrjedhojë e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë nr. 1280, datë 29.6.2010, të Gjykatës së Apelit Tiranë, për sa i përket mos kthimit në punë të kërkuesit.

- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë pro: Bashkim Dedja (kryetar), Sokol Berberi, Gani Dizdari, Fatmir Hoxha, Besnik Imeraj.

Anëtarë kundër: Vladimir Kristo, Altina Xhoxhaj, Vitore Tusha, Fatos Lulo.

MENDIM PAKICE

1. Shumica, duke pranuar pjesërisht kërkesën e shtetasit Kudret Kopo, ka konstatuar cenimin e së drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor si rrjedhojë e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë nr. 1280, datë 29.6.2010 të Gjykatës së Apelit Tiranë, vetëm sa i përket moskthimit në vendin e mëparshëm të punës të kërkuesit. Shumica ka konstatuar se Këshilli i Lartë i Drejtësisë (KLD), megjithëse ka pasur vende vakante për inspektorë, nuk ka rikthyer kërkuesin në këtë detyrë, por ka emëruar persona të tjerë, duke mos përmbushur detyrimin që buronte nga vendimi gjyqësor i formës së prerë (*shih paragrafët 31 dhe 33 të vendimit*).

2. Në ndryshim nga shumica, vlerësoj se në rastin konkret, pretendimi i kërkuesit nuk është i bazuar dhe se kërkesa e tij duhet rrëzuar.

3. Gjykata, në jurisprudencën e saj, sikurse ka theksuar edhe shumica, është shprehur se i takon debitorit të gjejë një mundësi zgjidhjeje sa më të përshtatshme me qëllim vënien në vend të së drejtës së kreditorit (*shih vendimin nr. 2, datë 1.2.2011 të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë aspekt, shteti duhet të marrë përsipër vazhdimisht detyrimin për të siguruar palët pjesëmarrëse në proces se do të kenë mundësi reale të ekzekutojnë vendimin gjyqësor të formës së prerë dhe se e drejta për të pasur akses në gjykatë do të ishte iluzion, nëse sistemi ligjor ose zbatimi i tij në praktikë

¹ Kryetari z.Bashkim Dedja dhe gjyqtari z.Sokol Berberi u shprehën për pranimin tërësisht të kërkesës.

do të bëhej shkak që një vendim gjyqësor i formës së prerë të mbetet pa efekt dhe i pazbatueshëm (*shih vendimet nr. 13, datë 21.3.2012; nr. 43, datë 19.12.2007 të Gjykatës Kushtetuese*).

4. Në gjykimin tim, vlerësoj se çështje të kësaj natyre duhen shqyrtuar rast pas rasti duke evidentuar veçoritë e secilës prej tyre. Në rastin në shqyrtim, Gjykata e Apelit Tiranë me vendimin nr. 1280, datë 29.6.2010, duke gjykuar çështjen në fakt, ka vendosur, ndër të tjera, detyrimin e KLD-së, të pranojë kërkuesin që të vazhdojë detyrën e inspektorit deri në mbarimin e afatit të dytë 5-vjeçar, si dhe t'i paguajë kërkuesit pagën si inspektor, që nga momenti i ndërprerjes së marrëdhënies së punës në datën 8.9.2008 deri në ditën e ekzekutimit të vendimit (*shih paragrafin 3 të vendimit*).

5. Siç rezulton nga materialet e administruara gjatë gjykimit, KLD-ja ndonëse nuk ka pranuar që kërkuesi, sipas vendimit të gjykatës, të vazhdojë detyrën e inspektorit deri në mbarim të mandatit të dytë 5-vjeçar, i ka paguar atij pagën e plotë për të gjithë këtë periudhë. Në këto rrethana, çmoj se vendimi i gjykatës është ekzekutuar plotësisht përderisa marrëdhënia e punës është e lidhur ngushtë me pagimin e pagës dhe si e tillë nuk mund të ekzistojë në mënyrë të pavarur.

6. Në kushtet e mbarimit të mandatit të dytë dhe të shlyerjes së pagesës për këtë mandat, në këndvështrimin tim, vendimi i gjykatës duhet të konsiderohet i ekzekutuar. Si pasojë, KLD-ja nuk ka më asnjë detyrim për të përmbushur. Nëse kërkuesi pretendon të emërohet si gjyqtar apeli, duhet t'i nënshtrohet procedurave të përcaktuara nga ligji. Një qëndrim i kundërt, si në rastin në fjalë, bie ndesh me standardin e vendosur nga kjo Gjykatë, dhe njëkohësisht e bën vendimmarrjen e saj formale dhe aspak efektive.

Anëtar: Vladimir Kristo.

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare me çmimin 16 000 lekë ose pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare me çmimin 14 000 lekë (ky çmim nuk përfshin shpërndarjen në adresë)

	Formati: 61x86/8
--	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2014

Çmimi 12 lekë

Adresa: bulevardi "Gjergj Fishta", pas ish-ekspozitës "Shqipëria Sot",
Tel: 04 24 27 005, 04 24 27 006